

LIGJI Nr. 05/L-051

PËR TREGUESIT GJEOGRAFIK DHE PËR EMËRTIMET E ORIGJINËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR TREGUESIT GJEOGRAFIK DHE PËR EMËRTIMET E ORIGJINËS

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

2. Ky ligj është në përputhshmëri me:

2.1. Rregulloren (BE) Nr 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produkteve ushqimore OJ L 343, 2012/12/14, f. 1-29;

2.2. Direktiven 2004/48/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së të prillit 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (OJ L 157, p.45, 2004/04/30, OJ L 195, f.16, 2004/06/02).

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha produktet për të cilat mbrojtja e emërtimeve të origjinës ka origjinë nga një rajon, vend specifik ose shtet.

**Neni 3
Përjashtimet**

Ky ligj nuk zbatohen për ato produktet për të cilat mbrojtja e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik është e rregulluar me ligj të veçantë.

Neni 4 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Ministria** - Ministria përkatëse për Tregti dhe Industri;

1.2. **Ministër** - Ministri përkatës për Tregti dhe Industri;

1.3. **Emërtim origjine** - emrin e një rajoni, të një vendi specifik apo në raste të veçanta, emri i një shteti, i cili përdoret për të përshkruar një produkt që ka origjinë nga ai rajon, vend specifik ose shtet, cilësitë ose karakteristikat e të cilit janë esencialisht ose ekskluzivisht si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë me faktorët natyrorë dhe njerëzorë të trashëguar nga ky mjedis, dhe si rezultat i prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes së produktit e cila zhvillohet tërësisht në zonën e përcaktuar gjeografike;

1.4 **Tregues gjeografik** - emrin e një rajoni, të një vendi specifik apo në raste të veçanta emri i një shteti, që përdoret për të përshkruar një produkt që ka origjinë nga ai rajoni, vend specifik ose shtet, zotëron një cilësi, reputacion apo karakteristika tjera specifike të cilat vijnë si rezultat i origjinës gjeografike, prodhimi dhe/ose përpunimi dhe/apo përgatitja e të cilit zhvillohet tërësisht në zonën e përcaktuar gjeografike;

1.5 **Agjencia** - Agjencia për Pronësi Industriale (këtu e tutje API) e cila është përgjegjëse për procedurën e regjistrimit të emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik dhe për procedurat tjera sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;

1.6. **Emër gjenerik** - emrin e një produkti i cili edhe pse lidhet me vendin apo rajonin ku ky produkt fillimisht është prodhuar ose tregtuar, është bërë emër i zakonshëm i një produkti në Kosovë;

1.7. **Vendi i origjinës** - sistemet rajonale në të cilat është dhënë mbrojtja e emërtimeve të origjinës apo e treguesit gjeografik për produktet që lidhen me një zonë gjeografike e cila shtrihet në një apo disa shtete pjesë e atij sistemi rajonal;

1.8. **Regjistri** – regjistri i emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe i treguesve të mbrojtur gjeografik;

1.9. **Regjistri i përdoruesve të autorizuar** - regjistri i përdoruesve të autorizuar të emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve të mbrojtur gjeografik.

2. Emërtimet e caktuara gjeografike pavarësisht nga nënparagrafi 1.7 të këtij neni, do të trajtohen si emërtime të origjinës, kur dëshmojnë karakter tradicional dhe një reputacion dhe famë të jashtëzakonshme dhe lënda e parë e produktet në fjalë vjen nga një zonë gjeografike më e gjerë ose e ndryshme nga, zona ku përpunohet produkti, me kusht që:

2.1. zona e prodhimit të lëndës së parë të jetë e përcaktuar;

2.2. të ekzistojnë kushte të veçanta për prodhimin e lëndës së parë; dhe

2.3. të ekziston baza juridike për inspektim, që sigurojnë respektimin e kushteve të

përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

3. Vetëm kafshët e gjalla, mishi dhe qumështi mund të konsiderohen si lëndë e parë për produkte bujqësore apo ushqime për qëllim të paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 5

Emrat Tradicional

Emrat tradicional gjeografik apo jo-gjeografik që emërtojnë një produkt apo i cili përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji konsiderohen si emërtime të origjinës apo tregues gjeografik.

Neni 6

Agjencia e pronësisë industriale

Agjencia është përgjegjëse për procedurën e regjistrimit të emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik dhe për procedurat tjera sipas këtij ligji dhe legjisllacionit në fuqi.

Neni 7

Shqyrtimi i vendimeve të marra nga API

1. Kundër vendimeve të API-së lejohet ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
2. Ankesa i drejtohet Komisionit të shqyrtimit të Ankesave në API e që detyrohet, të vendosë dhe ta njoftojë palën.
3. Komisioni i shqyrtimit të ankesave formohet me vendim të Ministrit.
4. Kompetencë e Komisionit është shqyrtimi i të gjitha ankesave të cilat palët i paraqesin kundër vendimi të API-së në fushën e treguesit gjeografik dhe emërtime të origjinës.
5. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente për çështje administrative në afat prej tridhjetë (30) ditësh.
6. Ministria me akt nënligjor e përcakton punën e Komisionit dhe procedurat e parashtrimit të ankesave.

Neni 8

Përfaqësimi

1. Personat fizik dhe juridik me vendbanim apo seli të biznesit në Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtje dhe kanë të drejtë të veprojnë si palë në procedurat e zhvilluara pranë API-së.
2. Personat fizik apo juridik që nuk janë banorë të Republikës së Kosovës apo nuk kanë vendbanim apo seli për biznese në Kosovës, në procedurat që zhvillohen në kuadër të API-së përfaqësohen përmes përfaqësuesve të autorizuar, me përjashtim në rastet e ekzistimit të ndonjë marrëveshje ndërkombëtare apo bilaterale që rregullon përfaqësimin reciprok të hartuar nga API.

KAPITULLI II

MBROJTJA E EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE TREGUESVE GJEOGRAFIK

Neni 9

Bazat për refuzim

1. Një emër nuk mund të regjistrohet si emërtim i origjinës apo tregues gjeografik nëse:

1.1. është emër gjenerik, siç është përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i këtij ligji;

1.2. bie në konflikt me emrin e një varieteti bimor apo race shtazore dhe si rezultat do të mashtronte konsumatorin për origjinën e vërtetë të produktit;

1.3. tregon apo sugjeron se produkti ka prejardhje nga një zonë tjetër gjeografike dhe jo nga vendi i saktë i prejardhjes i cili e çorienton apo keqinformon publikun lidhur me origjinën gjeografike të produktit;

1.4. mashtron konsumatorin të besoj se produkti vjen nga një territor tjetër edhe nëse territori, rajoni apo vendi i origjinës së produktit është i saktë dhe i vërtetë;

1.5. krijon konfuzion në treg në lidhje me llojin, origjinën, kualitetin, mënyrën e prodhimit ose karakteristikat tjera të produktit;

1.6. është në kundërshtim me rendin apo moralin publik;

1.7. në lidhje me reputacionin, njohjen e markës tregtare dhe të periudhës kohore të përdorimit të saj, regjistrimi besohet se do ta çorientojë konsumatorin sikur të jetë identiteti i vërtetë i produktit.

2. Për të përcaktuar nëse një emër është bërë apo nuk është bërë gjenerik, merren parasysh të gjithë faktorët, veçanërisht gjendja ekzistuese në Kosovë dhe zonat e konsumimit si dhe legjislacionit në fuqi.

3. Duke marrë parasysh reputacionin e markës tregtare si dhe kohëzgjatjen e përdorimit të saj, me anë të regjistrimit ekziston mundësia e çorientimit të konsumatorit lidhur me identitetin e vërtetë të produktit.

Neni 10

Homonimet e emërtimeve të origjinës apo treguesve gjeografik

1. Emri i propozuar për regjistrim i cili është tërësisht ose pjesërisht homonim me emrin e evidentuar në regjistrin e emërtimeve të mbrojtura të origjinës ose treguesve të mbrojtur gjeografik, mund të mos regjistrohet derisa të mos ketë dallueshmëri të mjaftueshëm në praktikë mes kushteve të përdorimit lokal dhe tradicional dhe prezantim të homonimit të regjistruar më vonë si emrin tashmë të evidentuar në Regjistër, duke pasur parasysh nevojën për trajtim të barabartë të prodhuesve në fjalë dhe mos çorientimin e konsumatorëve.

2. Emri homonim i cili e çorienton konsumatorin për të besuar që produktet kanë prejardhje nga

një territor tjetër nuk duhet të regjistrohen edhe në qoftë se emri është i saktë derisa territori aktual, rajoni ose vendi i origjinës së produkteve në fjalë është i pasigurt.

Neni 11

Emrat e origjinës dhe treguesit gjeografik që kanë të bëjnë me zonat gjeografike jashtë Kosovës

1. Çdo person fizik apo juridik mund të aplikon për mbrojtjen e emrit të origjinës ose të treguesit gjeografik sipas dispozitave të përcaktuara të këtij ligji.

2. Nëse emri i origjinës apo treguesi gjeografik ka të bëjë me zonat gjeografike jashtë Kosovës, mbrojtja jepet nëse aplikacioni përputhet me kriteret e përcaktuara në këtë ligj si dhe nëse emri në fjalë është i mbrojtur në vendin e origjinës. Pavarësisht nga dispozita e nenit 9 të këtij ligji, në këto raste një emër nuk mund të regjistrohet si emërtim i origjinës apo tregues gjeografik kur nuk është mbrojtur ose nuk mbrohet në vazhdimësi apo nuk përdoret në vendin e origjinës.

3. Mbrojtja e emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik mund të jepet gjithashtu në bazë të marrëveshjeve bilaterale apo ndërkombëtare mbi mbrojtjen e ndërsjellë të emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik të me të cilat Republika e Kosovës lidh marrëveshje.

4. Fusha e mbrojtjes së këtyre emërtimeve të origjinës apo treguesve gjeografik do të jetë e njëjtë me mbrojtjen e dhënë për emërtimet e origjinës apo treguesit gjeografik në bazë të këtij ligji nëse dhe deri në atë masë që marrëveshja përkatëse bilaterale apo ndërkombëtare nuk e parashikon ndryshe.

Neni 12

Fusha e mbrojtjes

1. Emërtimet e origjinës apo treguesit gjeografik të regjistruar do të mbrohet ndaj:

1.1. çdo përdorimi direkt apo indirekt në tregti të produkteve të cilat nuk janë regjistruara për aq kohë sa këto produkte janë të krahasueshme me produktet e regjistruara nën emërtimin e origjinës, apo për aq kohë sa përdorimi i emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik shfrytëzon reputacionin e emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik të mbrojtur;

1.2. çdo keqpërdorimi, imitimi apo evokimi, edhe po që se shënohet origjina e vërtet e produktit apo nëse emri i emërtimit të origjinës apo treguesi gjeografik është i përkthyer apo i transliteruar apo është shoqëruar shprehje të tillë si “stil”, “lloj”, “metodë”, “si prodhohet në”, “imitim”, apo të tjera të ngjashme me to;

1.3. çdo treguesi të pasaktë apo çorientues për sa i përket prejardhjes, origjinës, natyrës apo cilësive thelbësore të produktit, në paketimin e brendshëm apo të jashtëm, në materialet e reklamimit apo dokumentet për produktin, dhe paketimi i produktit në kontejner që ka prirje të jap përshtypje të gabuar për sa i përket origjinës;

1.4. çdo veprim tjetër që mund të çorientoj konsumuesin për sa i përket origjinës së vërtet të produktit.

2. Kur emërtimi i origjinës apo treguesi gjeografik përmban brenda vetes emrin e produktit i cili

konsiderohet të jetë gjenerik, përdorimi i emrit gjenerik ne produktet përkatëse nuk konsiderohet të jetë në kundërshtim me paragrafin 1, nënparagrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni.

3. Emërtimet e origjinës apo treguesit gjeografik të regjistruar nuk mund të bëhen gjenerik.

4. Emërtimet e origjinës apo treguesit gjeografik të regjistruar nuk përjashton të drejtën e përdorimit nga çdo person, në treg, emrin e tij apo emrin e ndërmarrjes së tij përveç atëherë kur emri i tillë përdoret në mënyrë të tillë që çorienton publikun.

Neni 13

Marrëdhëniet në mes markave tregtare, emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik

1. Kur një emërtim i origjinës apo tregues gjeografik është i regjistruar sipas këtij ligji, refuzohet aplikimi për regjistrimin e një marke tregtare që korrespondon me njërën nga situatat e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji lidhur me të njëjtin tip të produktit nëse aplikimi për regjistrim të markës tregtare është parashtruar për regjistrim pas datës së parashtrimit të aplikacionit për regjistrim në bazë të këtij ligji.

2. Marka tregtare e regjistruar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni do të shfuqizohet nga API.

3. Një markë tregtare, përdorimi i së cilës korrespondon me njërën nga situatat e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, dhe për të cilën është aplikuar për regjistrim në mirëbesim në Kosovë para datës së parashtrimit të aplikacionit për regjistrim sipas këtij ligji mund të vazhdojë të përdoret pavarësisht nga regjistrimi i emërtimeve të origjinës apo treguesit gjeografik po që se nuk ekziston baza për shfuqizim apo revokim të saj në bazë të Ligjit për Markat Tregtare. Në raste të tilla, përdorimi i treguesit gjeografikë të mbrojtur ose emërtimeve të mbrojtur të origjinës lejohet të përdoret sikur marka tregtare relevante.

Neni 14

E drejta e përdorimit

1. Një emërtim i origjinës apo tregues gjeografik i regjistruar sipas këtij ligji mund të përdoret nga çdo prodhues apo përpunues për reklamim të produktit kur sigurohet që këto produkte janë në pajtim me specifikimet përkatëse dhe prodhuesi apo përpunuesi është i regjistruar në Regjistrin e Përdoruesve të Autorizuar.

2. Çdo produkt me prejardhje nga Kosova që tregtohet në bazë të emërtimeve të origjinës apo treguesit gjeografik në pajtim me këtë ligj duhet të etiketohet me treguesin “emërtim i origjinës i mbrojtur” dhe “tregues gjeografik i mbrojtur” apo simbole që i shoqërojnë apo ato.

3. Çdo produkt me prejardhje jashtë Kosovës që tregtohet në bazë të emërtimeve të origjinës apo treguesit gjeografik të regjistruar në pajtim me këtë ligj njësoj mund të etiketohet me treguesin “emërtim i origjinës i mbrojtur” dhe “tregues gjeografik i mbrojtur” apo simbole që ndërlidhen me ato.

4. Ministria me akt nënligjor rregullon simbolet e projektuara për të publikuar emërtimin e mbrojtur të origjinës dhe treguesin e mbrojtur gjeografik dhe për ta shoqëruar treguesin “emërtim i origjinës i mbrojtur” dhe “tregues gjeografik i mbrojtur”.

Neni 15
Kohëzgjatja e mbrojtjes

1. Mbrojtja e emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik të regjistruar sipas këtij ligji fillon që nga data e hyrjes në Regjistrin e emërtimeve të origjinës apo treguesve gjeografik të regjistruar.

2. E drejta e përdorimit të emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik zgjatë për dhjetë (10) vite që nga data e regjistrimit të përdoruesit të autorizuar në Regjistrin e Përdoruesve të Autorizuar dhe mund të përtërihet nga ana e palës pafundësisht për periudha dhjetë (10) vjeçare në bazë të dispozitave të këtij ligji për sa kohë që emërtimi i origjinës apo treguesi gjeografik është i regjistruar.

KAPITULLI III
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË MBROJTJES

Neni 16
Mbrojtja e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik

Emërtimeve të origjinës apo treguesve gjeografik u jepet mbrojtje me vendimin për regjistrim pas përfundimit të procedurave administrative nga API dhe regjistrimit në regjistrin përkatës.

Neni 17
Dhënia e të drejtës së përdorimit të emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik

E drejta e përdorimit të emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik jepet me vendimin për regjistrimin e përdoruesit të autorizuar, pas përfundimit të procedurave administrative nga API.

Neni 18
Tarifat

Ministria me akt nënligjor rregullon shumën e tarifave dhe procedurat e regjistrimit të emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik në API.

Neni 19
Regjistrat

Regjistri dhe Regjistri i Përdoruesve të Autorizuar të përcaktuar me këtë Ligj janë publik për çdo person të interesuar dhe pa ndonjë tarifë apo pagesë të veçantë.

Neni 20
Treguesit gjeografik ndërkufitar

Në rastin e një emri që emërton një zonë gjeografike ndërkufitare ose të emrit tradicional të lidhur me një zonë gjeografike ndërkufitare, disa grupe mund të paraqesin një aplikim të përbashkët.

KAPITULLI IV

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE TREGUESVE GJEOGRAFIK

Neni 21

Fillimi i procedues së regjistrimit

1. Procedura për regjistrim të një emërtimi të origjinës apo një treguesi gjeografik fillohet me plotësimin e aplikacionit për regjistrim në API.
2. Aplikacioni për regjistrim mund të ketë vetëm një emërtim të origjinës apo një tregues gjeografik të lidhur me vetëm një lloj të produktit.

Neni 22

E drejta për të aplikuar

1. Të drejtën për të aplikuar për regjistrim të emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik e ka:
 - 1.1. çdo shoqatë e prodhuesve apo përpunuesve që punojnë më të njëjtin produkt, pa marrë parasysh përbërjen apo formën e saj ligjore;
 - 1.2. një person i vetëm fizik apo juridik me kusht që të paraqitet në kohën e plotësimit të aplikacionit për regjistrim, se personi në fjalë është i vetmi prodhues në zonën e përcaktuar gjeografike i gatshëm të dorëzojë një aplikacion dhe se zona e përcaktuar gjeografike posedon karakteristika të cilat dukshëm ndryshojnë nga ato të zonave fqinje apo karakteristikat e produktit janë të ndryshme prej atyre që prodhohen në zonat fqinje;
 - 1.3. një shoqatë e prodhuesve apo përpunuesve apo një person i vetëm i cili plotëson kërkesat e caktuara në paragrafin 1. nënparagrafin 1.2. të këtij neni, mund të aplikojnë për regjistrim të një emërtimi të origjinës apo treguesi gjeografik për produktin të cilin ata e prodhojnë apo e ofrojnë.

Neni 23

Përmbajtja e aplikacionit për regjistrim

1. Aplikacioni për regjistrim përfshinë:
 - 1.1. emrin dhe adresën e çdo shoqate të prodhuesve apo përpunuesve që aplikon të shoqëruar me informata për statusin ligjor dhe përbërjen, nëse aplikacioni plotësohet nga një shoqatë e prodhuesve apo përpunuesve;
 - 1.2. emrin dhe adresën e personit që aplikon të shoqëruar me prova adekuate për statusin ligjor, nëse aplikacioni plotësohet nga një person i vetëm;
 - 1.3. emri i emërtimit të origjinës apo të treguesit gjeografik;
 - 1.4. përshkrimin e produktit;

- 1.5. përcaktimin e zonës gjeografike;
- 1.6. specifikacionet e produktit ;
- 1.7. përshkrimin e lidhjes në mes produktit dhe origjinës gjeografike të përcaktuara me këtë Ligj, varësisht prej rastit;
- 1.8. dëshminë mbi pagesat e kryera të tarifave e përcaktuara;
- 1.9. autorizimin nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar;
- 1.10. dëshmi mbi mbrojtjen e emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik në vendin e tij sipas nenit 8 dhe 11 të këtij Ligji, në formë të kopjes së një certifikate apo dokumenti tjetër ligjor në gjuhën zyrtare të vendit të origjinës me përkthim të dokumentit, nëse emri i origjinës apo treguesi gjeografik ka të bëjë me një zonë gjeografike të vendosur jashtë Kosovës.

Neni 24

Përshkrimi i produktit

1. Përshkrimi i produktit, për tu përcaktuar nga emërtimi i origjinës apo treguesi gjeografik duhet të përfshijë të dhëna specifike teknike që përdoren zakonisht për ta përshkruar atë lloj produkti, përfshirë edhe karakteristikat ndijore – organoleptike kurdo që të jetë e përshtatshme.
2. Përshkrimi i këtij produkti përfshinë, kur të jetë e përshtatshme, rregulla specifike lidhur me paketimin, ambalazhimin dhe etiketën.

Neni 25

Përcaktimi i zonës gjeografike

Zona gjeografike përcaktohet në një mënyrë të hollësishme dhe të përpiktë që nuk paraqet ndonjë dykuptimësi dhe cakton kufijtë në kuptim të lidhjes në mes cilësisë apo karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik të përcaktuara me këtë Ligj apo në kuptim të lidhjes në mes të një cilësie specifike, reputacionit apo ndonjë karakteristike tjetër të produktit dhe origjinës gjeografike të përcaktuara me këtë Ligj, ose në kuptim të marrëdhënieve mes kualitetit specifik, reputacionit ose ndonjë karakteristike tjetër të produktit dhe origjinës gjeografike të përcaktuar në nën-paragrafin 1.4 të paragrafit 1, të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 26

Specifikacioni i produktit

1. Specifikacioni i produktit përmban:
 - 1.1. emrin e produktit që përmban emërtimin e origjinës apo treguesin gjeografik, siç është përdorur, gjatë tregimit ose në gjuhën e zakonore, dhe vetëm në gjuhët që janë ose ishin përdorur historikisht për të përshkruar produktin e veçantë në hapësirën e caktuar gjeografike;
 - 1.2. përshkrimin e produktit përfshirë lëndën e parë, nëse është e mundur, si dhe

karakteristikat kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike, ndijore – organoleptike apo karakteristikat tjera të produktit ;

1.3. përcaktimin e zonës gjeografike dhe, nëse është e mundur, hollësitë që tregojnë pajtueshmëri me kërkesat në nenin 4, paragrafi 2 të këtij ligji;

1.4. dëshminë që produkti ka prejardhje nga zona e përcaktuar gjeografike në pajtim me këtë ligji;

1.5. përshkrimin e metodës së përfitimit të produktit dhe, nëse është e mundur, metodat vendore autentike të pandryshuara si dhe informata lidhur me paketimin, nëse personi që aplikon përcakton, jep arsye dhe justifikim specifik për produktin, se pse paketimi duhet të bëhet në zonën e përcaktuar gjeografike për të ruajtur kualitetin e origjinës apo për të siguruar kontroll;

1.6. hollësitë që vërtetojnë lidhjen në mes të cilësisë apo karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik në pajtim me këtë ligji apo lidhjen në mes cilësisë specifike, reputacionit apo karakteristik tjetër të produktit dhe origjinës gjeografike të përcaktuar me këtë ligj.

1.7. emrin dhe adresën e autoriteteve apo organeve që verifikojnë pajtueshmërinë e dispozitave të specifikacionit dhe detyrave të tyre specifike;

1.8. çdo rregull specifik i etiketës për produktin në fjalë;

1.9. rregulla të hollësishme për origjinën dhe cilësinë e ushqimit, për produktet me origjinë - prejardhjen shtazore të përcaktuara si emërtime të origjinës;

1.10. çdo kërkesë tjetër e cila përcaktohet në dispozitat e një ligji të veçantë apo në aktet nënligjore të miratuara nga Ministria përkatëse sipas këtij ligji.

Neni 27

Lidhja

1. Hollësitë që vërtetojnë lidhjet e përcaktuara në nenin 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të këtij ligji duhet të sqarojnë dhe shpjegojnë se si karakteristikat e zonës së përcaktuar gjeografike ndikojnë në produktin final. Kurdo që është e përshtatshme përfshihen edhe elementet specifike të përshkrimit të produktit apo metoda e prodhimit e cila e arsyeton lidhjen.

2. Hollësitë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni lidhur me emërtimet e origjinës duhet të përmbajnë:

2.1. hollësitë e zonës gjeografike, përshirë faktorin njeri dhe faktorin natyror, përkatës për lidhjen;

2.2. hollësitë e cilësisë apo karakteristikave të produktit që janë esencialisht ose ekskluzivisht si rezultat i mjedisit gjeografik;

2.3. përshkrimi i bashkëveprimit në mes të hollësive sipas nën-paragrafit 2.1.

3. Hollësitë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni lidhur me treguesit gjeografik duhet të përmbajnë:

3.1. hollësitë e zonës gjeografike me ndikim për lidhje;

3.2. hollësitë e kualitetit specifik, reputacionit apo karakteristikat tjera të produktit që i atribuohen origjinës gjeografike së bashku me deklaratën nëse treguesi gjeografik është i bazuar në ndonjë cilësi a reputacion të veçantë apo në karakteristika të tjera që i atribuohen origjinës gjeografike;

3.3. përshkrimi i bashkëveprimit të rastësishëm në mes hollësive në bazë të nën-paragrafëve 3.1. dhe 3.2. të këtij paragrafi.

Neni 28

Verifikimi i pajtueshmërisë

1. Autoritetet apo organet e autorizuar për verifikimin e pajtueshmërisë së produktit me dispozitat e specifikacionit duhet të jenë institucione të autorizuar dhe të pranuar për verifikim të pajtueshmërisë së produkteve me dispozitat e specifikacionit - Trupat Çertifikuese - në përputhje me legjislacionin në fuqi për pajtueshmërinë nga Trupat Çertifikuese.

2. Ministria duhet t'i bëjë publike emrin dhe adresën e autoriteteve dhe trupave që veprojnë si Trupa Çertifikuese dhe që në mënyrë periodike ta bëjë përditësimin e atyre informatave.

3. Trupat certifikuese sigurojnë që verifikimi i pajtueshmërisë së produktit me dispozitat e specifikacionit të jetë kryer para se ta vendosin produktin në treg.

4. Për sa i përket emrave të origjinës apo treguesve gjeografik lidhur me zonën gjeografike që ndodhet jashtë Kosovës verifikimi i pajtueshmërisë së produktit me dispozitat e specifikacionit para vendosjes së produktit në treg sigurohen nga autoritetet publike të përcaktuara nga vendi i origjinës dhe/apo nga trupat certifikuese të produktit.

5. Shpenzimet për verifikimin e tillë të pajtueshmërisë së produktit me dispozitat e specifikacionit barten nga përdoruesit e autorizuar të nënshtruar ndaj kontrollit.

Neni 29

Verifikimi i produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë

1. Në rast të produkteve bujqësore apo artikujve ushqimorë trupat certifikuese të cekura në nenin 28 të këtij ligji miratohen nga Ministri i Ministrisë përkatëse për Bujqësi. Kushtet e veçanta të cilat kërkohen për certifikim, lista e organeve të miratuara dhe çështje tjera të kësaj natyra do të përcaktohen nga Ministri i Ministrisë përkatëse për Bujqësi.

2. Hollësitë për kushtet dhe procedurën për verifikim të pajtueshmërisë me produktin bujqësorë apo artikullin ushqimor me dispozitat e specifikacionit, në rast se trupat certifikuese kanë vërtetuar se produkti nuk përputhet me dispozitat e specifikacionit, procedura si dhe mënyra e caktimit të tarifave për verifikim nga trupat certifikuese përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria përkatëse për Bujqësi.

Neni 30

Ekzaminimi i aplikimit

1. API kontrollon nëse aplikacioni i parashtruar përmban të gjitha dokumentet e kërkuara sipas nenit 23 të këtij ligji dhe nxjerr vendim në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.
2. Nëse API konstaton se aplikacioni nuk përmban të gjitha dokumentat e nevojshme në bazë të nenit 23 të këtij ligji, API fton personin që aplikon të korrigjoj aplikacionin brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh.
3. Me kërkesës së aplikuesit, e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohorë të referuar në paragrafin 2 të këtij neni, afati kohor mund të zgjatet për maksimum tridhjetë (30) ditë duke llogaritur që nga data e skadimit të atij afati.
4. Nëse personi që aplikon nuk e korrigjon aplikacionin e tij bazuar në ftesën e API –së apo dështon të korrigjoj atë brenda afatit të përcaktuar , aplikacioni do të refuzohet.

Neni 31

Kontrollimi i aplikacionit për mbrojtje

1. Nëse aplikacioni i plotëson kushtet sipas nenit 30 të këtij ligji API ekzaminon më tej nëse aplikacioni i përmbush kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e emrit të origjinës apo treguesve gjeografik dhe në veçanti nëse plotëson kërkesat e përcaktuara prej nenit 22 deri tek neni 29 të këtij ligji.
2. Nëse API konstaton se aplikacioni nuk përputhet me kërkesat e nevojshme, API njofton personin që aplikon me shkrim lidhur me arsyet se pse mbrojtja e emrit të origjinës apo treguesit gjeografik nuk i është lejuar dhe do ta ftojë atë të dorëzojë vërejtjen e tij brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve.
3. Me anë të kërkesës nga personin që aplikon, e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohorë të referuar në paragrafin 2. të këtij neni, ai afat i kufizuar kohorë mund të zgjatet deri në maksimum tridhjetë (30) ditë i llogaritur që nga data e skadimit të afati .
4. Nëse personin që aplikon nuk dorëzon ndonjë vërejtje apo nëse përkundër vërejtjes së tij, API konsideron se personin që aplikon nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara për mbrojtje të emrit të origjinës apo treguesit gjeografik, aplikacioni refuzohet.
5. Nëse API pas perfundimit së procedurës në përputhje me dispozitat e këtij neni konsideron se personin që aplikon përmbush kërkesat e përcaktuara për mbrojtje të emrit të origjinës apo treguesit gjeografik, do ta publikoj në Buletinin e saj zyrtare pjesën e aplikacionit për regjistrim të emrit të origjinës apo treguesit gjeografik që është i përcaktuar në nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3., 1.4., 1.5. dhe 1.7. të këtij ligji.

Neni 32

Kontrollimi i produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë

1. Në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimor kontrollimi dhe vendimi i përcaktuar në nenin 31 të këtij ligji do të kryhen dhe merren nga një komision ekspertësh i përbërë nga dy (2) ekspert të emëruar nga Ministria përkatëse për Bujqësi, një (1) nga Agjencia e Ushqimit dhe

Veterinarisë dhe dy (2) nga API-ja.

2. Ekspertët nga paragrafi 1 i këtij neni emërohen nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë sipas rastit.

Neni 33 **Kundërshtimi**

1. Brenda tre (3) muajve nga data e publikimit të aplikimit sipas nenit 31, paragrafit 5. të këtij ligji, çdo person i interesuar që ka një interes legjitim mund të parashtoj kundërshtim ndaj regjistrimit të propozuar të emrit të origjinës apo treguesit gjeografik sipas kushteve në vijim:

1.1. që nuk pajtohet me përkufizimet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji; apo,

1.2. që regjistrimi i emrit të propozuar do të jetë në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2. dhe 1.3 apo nenit 10 të këtij ligji; apo

1.3. që regjistrimi i emrit të propozuar do të rrezikonte ekzistencën e pjeshme apo komplete të një emri identik apo marke tregtare apo ekzistencën e produkteve të cilët kanë qenë ligjërish në treg për së paku pesë (5) vite duke i paraprirë datës së publikimit të përcaktuar në nenin 31, paragrafi 5 të këtij ligji; apo

1.4. ai emër për të cilin kërkohet regjistrimi është gjenerik në kuptimit të nenit 9, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1. të këtij ligji.

Neni 34 **Procedura e kundërshtimit**

1. API kontrollon nëse kundërshtimi është parashtruar brenda afatit të caktuar kohorë të përcaktuar në paragrafin 1. të nenit 31 të këtij ligji dhe nëse janë dorëzuar dhe ekzistojnë dëshmitë që vërtetojnë bazën sipas së cilës është bërë kundërshtimi.

2. Nëse API konstaton se kundërshtimi nuk është parashtruar brenda afatit të caktuar apo që pala kundërshtuese nuk i ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara, kundërshtimi do të refuzohet.

3. Nëse API konstaton se kundërshtimi është parashtruar brenda afatit të caktuar dhe të gjitha dëshmitë e kërkuara janë dorëzuar, kundërshtimi së bashku me të gjitha dëshmitë e dorëzuara do t'i dërgohen personit që ka aplikuar. Personi që ka aplikuar do të ftohet që të paraqes vërejtjet e tij mbi kundërshtimin e bërë si dhe dëshmitë t'i dorëzoj brenda tridhjetë (30) ditëve.

4. Me anë të kërkesës së personit që aplikon, e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar cekur në paragrafin 3. të këtij neni, afati kohor mund të zgjatet edhe për tridhjetë (30) ditë llogaritur nga data e skadimit të afati.

5. API vendos se a është kundërshtimi i justifikuar në kuptim të përdorimit të drejtë dhe tradicional dhe mundësisë aktuale të konfuzionit

6. Nëse API konstaton se kundërshtimi është i justifikuar, ajo do të refuzoj aplikacionin për regjistrim të një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik.

7. Nëse API konstaton se kundërshtimi nuk është i justifikuar ajo do ta refuzoj kundërshtimin dhe do të vazhdoj me procedurën e regjistrimit.

Neni 35

Regjistrimi i një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik

1. Nëse aplikacioni për regjistrimin e një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik i plotëson të gjitha kriteret e percaktuara për mbrojtjen e emrit të origjinës apo treguesit gjeografik dhe pas shqyrtimit të kundërshtimeve nëse ka, API lëshon vendim për regjistrimin e një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik dhe do të regjistroj emrin e mbrojtur të origjinës apo treguesin gjeografik në Regjistër.

2. Regjistrimi do të publikohet në Buletinin zyrtar të API –së.

3. Të dhënat për publikim për regjistrimin e një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

Neni 36

Përmbajtja e shënimeve në Regjistër

1. API me rastin e regjistrimit në regjistër të emrit të mbrojtur të origjinës apo treguesit gjeografik, regjistron të dhënat si ne vijim:

1.1. emrin e regjistruar të produktit të mbrojtur nga një emër i origjinës apo një tregues gjeografik;

1.2. llojin, nëse emri është i mbrojtur si emër i origjinës apo tregues gjeografik;

1.3. llojin e produktit që përmban emrin e mbrojtur të origjinës apo treguesin gjeografik;

1.4. treguesin e vendit të origjinës;

1.5. të dhënat për vendimin e regjistrimit të një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik.

Neni 37

Ndryshimet në specifikacionin e produktit

1. Subjekti i cili ka të drejtë të aplikoj për regjistrim të një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik në bazë të nenit 22 të këtij Ligji dhe që ka një interes legjitim, mund të aplikoj për të ndryshuar specifikacionin e miratuar të produktit, në veçanti të merr parasysh zhvillimet dhe të arriturat shkencore dhe teknike apo të ri-përcaktoj zonën gjeografike të referuar në nënparagrafin 1.3. të paragrafit 1. të nenit 26 të këtij Ligji.

2. Aplikacioni për miratim të një ndryshimi në specifikacionin e produktit do të përshkruaj dhe paraqes arsyet për ndryshimin e kërkuar.

Neni 38

Procedura për ndryshimet e specifikacionit të produktit

1. Kur ndryshimi përfshinë një apo më shumë ndryshime lidhur me emrin, përshkrimin e produktit, përcaktimin e zonës gjeografike apo përshkrimin e lidhjes, procedura për ndryshim bëhet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 29 deri te neni 34 të këtij ligji.

2. Në rastin e tillë siç është përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni të dhënat e kërkuara në bazë të nën-paragrafit 1.10. të paragrafit 1. të nenit 23 të këtij ligji duhet të përmbajnë aplikacionin të kompletuar sipas rregullit në bazë të këtij neni si dhe specifikacionin e propozuar me të dhëna të reja të produktit.

3. Në rast të ndryshimit nga paragrafi 1. i këtij neni, të dhënat për publikim bëhen në përputhje me paragrafin 5. të nenit 31 të këtij ligji.

4. Në rast se ndryshimet do të konsiderohen të vogla dhe API do të vendos nëse do të miratoj kërkesën duke mos përcjell procedurën e përcaktuar prej nenit 33 deri 35 të këtij ligji, nëse ndryshimet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk:

- 4.1. lidhen me karakteristikat thelbësore të produktit;
- 4.2. nryshojnë lidhjet e referuara në nenin 26 të këtij ligji.
- 4.3. përfshijnë ndryshim të emrit, apo të ndonjë pjese të emrit të produktit;
- 4.4. ndikojnë në zonën e përcaktuar gjeografike;
- 4.5. përfaqësojnë një rritje në kufizimet e tregtisë së produktit apo lëndës së tij të parë.

5. Kur ndryshimi nuk përfshinë ndonjë ndryshim nga paragrafi 1. i këtij neni apo ka të bëjë më ndonjë ndryshim të përkohshëm në specifikacione që rezultojnë nga imponimi i masave të detyrueshme sanitare apo fitosanitare nga autoritetet publike, API përcakton nëse do të miratoj ndryshimin e propozuar.

6. Kur API vendos të pranoj një ndryshim në specifikacionin i cili përfshinë apo përmban një ndryshim të dhënave të regjistruara në Regjistër në bazë të nenit 36 të këtij ligji, këto ndryshime do të regjistrohen në regjistër dhe janë efektive që nga data kur është marrë vendimi për të pranuar ndryshimin.

Neni 39

Anulimi

1. Vendimi për mbrojtjen e një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik mund anulohet nëse API vërteton se:

- 1.1. gjatë kohës së plotësimit të aplikacionit për regjistrim kushtet për mbrojtjen e përcaktuar në bazë të këtij ligji nuk ishin plotësuar;
- 1.2. pajtueshmëria me kushtet e specifikacionit për produktin e mbuluar nga emri i

mbrojtur ka pushuar së ekzistuari;

1.3. në rast se një emër i origjinës apo një tregues gjeografik i cili ka të bëjë më një zonë gjeografike e cila ndodhet jashtë Kosovës, emri në fjalë nuk do të jetë më tutje i mbrojtur në vendin e tij të origjinës;

1.4. bazuar në një kërkesë të bazuar ligjore të një personi fizik apo juridik për anulimin e një vendimi të tillë për mbrojtjen e emrit të origjinës apo treguesit gjeografik;

1.5. për të paktën shtatë (7) vite në tregun e Republikës së Kosovës nuk është vendosur asnjë produkt me emër të mbrojtur të origjinës ose më tregues të mbrojtur gjeografik, duke ofruar dëshmi që janë plotësuar kushtet të përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, ose 1.4 të këtij neni.

2. Në rastet kur procedura e anulimit është e bazuar sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe nënparagrafin 1.4 të këtij neni, nenit 33, si dhe nenit 34 paragrafi 5 të këtij ligji, atëherë procedura e anulimit do të zbatohet sipas kushtëve të caktuara.

3. Kur një vendim për mbrojtjen e emrit të origjinës apo treguesit gjeografik është anuluar bazuar në kushtet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.1 të këtij neni, do të konsiderohet se emri i origjinës apo treguesi gjeografik nuk ka ekzistuar sipas këtij ligji.

Neni 40 **Procedura e Anulimit**

1. Anulimi i një vendimi për mbrojtjen e një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik mund të kërkohej nga çdo person juridik apo fizik i cili ka një interes legjitim apo nga Agjencia sipas detyrës zyrtare.

2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni përmban arsyet e kërkesës si dhe çdo informatë tjetër apo dokument që do të jetë i përshkruar në mënyrë të hollësishme me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

3. Nëse API konstaton se kërkesa nuk përmban të gjitha kushtet e përcaktuara në bazë të paragrafit 2. të këtij neni, kërkesa do të anulohet.

4. Nëse kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni përmban të gjitha kushtet e përcaktuara nga paragrafi 2. i këtij neni ajo do të publikohet në Buletinin Zyrtarë të API –së.

5. Brenda tre (3) muajsh që nga data e publikimit të dhënave për kërkesën për anulim të vendimit të mbrojtjes se një emri të origjinës apo treguesi gjeografik bazuar në paragrafin 4. të këtij neni çdo person i interesuar mund të jap një deklaratë për vërejtjen në kërkesën për anulim të vendimit për mbrojtje të një emri të origjinës apo treguesi gjeografik nëse një person i tillë mund të tregojë mbështetje të vazhdueshme komerciale për emrin e regjistruar.

6. Nëse API konstaton se kërkesa për anulimin e vendimit për mbrojtjen e emrit të origjinës apo treguesit gjeografik është e justifikuar, ajo anulon regjistrimin e emrit të origjinës apo një treguesi gjeografik, do të fshij shënimet nga Regjistri pasi që vendimi mbi anulim të merr formën e prerë dhe do të publikoj faktin në Buletinin Zyrtarë të API –së.

7. API refuzon kërkesën për anulimin e regjistrimit për mbrojtjen e një emri të origjinës apo një treguesi gjeografik nëse konstaton se ajo nuk është e bazuar.

Neni 41

Anulimi i procedurës për produkte bujqësore dhe artikujt ushqimorë

Në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë kontrollimi dhe vendimi i përcaktuar në nenin 40 të këtij ligji merret nga komisioni i ekspertëve i bazuar në nenin 32 të këtij ligji.

Neni 42

Anulimi i procedurës për emrat e origjinës apo treguesit gjeografik të cilët kanë të bëjnë me zonën gjeografike që ndodhet jashtë Kosovës

1. Në rast se anulimi kërkohet për arsyet e përcaktuara në nënparagrafin 1.3. të paragrafit 1. të nenit 39 të këtij ligji, pavarësisht prej dispozitës së paragrafit 1. të nenit 40 të këtij ligji, kërkesa ka mundësi që gjithashtu të parashtrohet nga autoritetet relevante të vendit të origjinës dhe pavarësisht prej dispozitës së paragrafit 2. të nenit 40 të këtij ligji kërkesa e tillë duhet që gjithashtu të shoqërohet me një kopje të certifikatës apo ndonjë dokumenti tjetër valid në gjuhen e vendit të origjinës dhe të përkthyer që vërteton se emri tash e tutje nuk është i mbrojtur në vendin e origjinës.

2. Në rast se kërkohet anulim i procedurës mbi bazat e përcaktuara në nënparagrafin 1.3. paragrafi 1. të nenit 39 dhe paragrafët 4. dhe 5. të nenit 40 të këtij ligji, nuk do të zbatohen.

Neni 43

Kufizimet për sa i përket administrimit

Një emër i regjistruar i origjinës apo treguesit gjeografik nuk mund të transferohet, licencohet, apo të jetë subjekt i të drejtave të njëjta, marrëveshjes së lirë apo çfarëdo forme e caktimit të të drejtave.

KAPITULLI V

PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E NJË PËRDORUESI TË AUTORIZUAR TË EMRIT TË MBROJTUR TË ORIGJINËS APO NJË TREGUESI GJEORAFIK

Neni 44

Inicimi i procedurës së regjistrimit

1. Procedura për regjistrimin e një përdoruesi të autorizuar të një emri të mbrojtur të origjinës apo treguesi gjeografik do të iniciohet duke parashtruar një aplikacion për regjistrim në API.

2. Aplikacioni nga paragrafi 1. i këtij neni mund të plotësohet nga çdo prodhues ose përpunues, qoftë person juridik apo fizik, i cili prodhon apo përpunon produktin e mbrojtur nga emri i origjinës apo treguesi gjeografik në pajtim me specifikacionet relevante të produktit.

3. Aplikacioni nga paragrafi 1. i këtij neni mund të plotësohet vetëm pasi që emri i origjinës apo treguesi gjeografik përkatës është regjistruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 45

Përmbajtja e aplikacionit për regjistrim nga përdoruesi i autorizuar

1. Aplikacioni për regjistrim të një përdoruesi të autorizuar duhet të përfshijë:
 - 1.1. një kërkesë nga përdoruesi i autorizuar;
 - 1.2. informaten që identifikon personin që aplikon;
 - 1.3. emrin e regjistruar i origjinës dhe treguesi gjeografik për të cilin personi që aplikon dëshiron të autorizohet për ta përdorur;
 - 1.4. llojin e produktit që përmban emrin e mbrojtur të origjinës apo treguesin gjeografik;
 - 1.5. informaten, përfshirë emrin dhe adresën, për autoritetet apo organet e besuara për verifikim të përputhjes së produktit me dispozitat e specifikacionit
2. Aplikacioni për regjistrim duhet të shoqërohet me dokumentet si në vijim:
 - 2.1. çertifikata e përputhjes së produktit me dispozitat e specifikacionit të lëshuar nga autoritetet apo organet e besuara për verifikimin e përputhjes së produktit me dispozitat e specifikacionit të identifikuar në aplikacion në pajtim me dispozitat e nenit 28 të këtij ligji;
 - 2.2. dëshmi e lëshuar nga autoriteti kompetent të personit që aplikon dhe kryen aktivitetin specifik apo prodhon produktin specifik në zonën gjeografike të përshkruar në specifikacionin e produktit;
 - 2.3. dëshmi për pagesën e kryer të tarifave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ përkatës për Tarifat Administrative pranë API-së.

Neni 46

Ekzaminimi i aplikimit

1. API kontrollon nëse aplikacioni i parashtruar i përdoruesit të autorizuar përmban të gjitha dokumentet e kërkuara konform nenit 44 të këtij ligji.
2. Nëse API konstaton se aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e nevojitura sipas nenit 44 të këtij ligji, API fton personin që aplikon të korrigjoj aplikacionin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve.
3. Me anë të kërkesës nga personi që aplikon, e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, afati i caktuar kohor mund të zgjatet edhe për tridhjetë (30) ditë duke llogaritur që nga data e skadimit të atij afati kohor.
4. Nëse personi që aplikon nuk e korrigjon aplikacionin në pajtim me ftesën e API-së apo dështon të korrigjoj atë brenda afatit të caktuar kohorë, aplikacioni për regjistrim të përdoruesit të autorizuar refuzohet.

Neni 47**Kontrollimi i aplikacionit për mbrojtje**

1. Nëse aplikacioni është në pajtim me nenin 46 të këtij ligji, API më tej kontrollon nëse kërkesat e përcaktuara për dhënien e të drejtës së përdorimit të emrit të origjinës apo treguesit gjeografik janë përmbushur.
2. Nëse API konstaton se aplikacioni nuk është në pajtim me kërkesat e përcaktuara, API njofton personin që aplikon, me shkrim, lidhur me arsyet se pse e drejta e përdorimit të një emri të mbrojtur të origjinës apo treguesi gjeografik nuk do ti lejohet dhe do ta ftoj atë të dorëzoj vërejtjen e tij brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve.
3. Me anë të kërkesës së personit që aplikon, e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohorë të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, ai afat kohorë mund të zgjatet edhe për një maksimum prej tridhjetë (30) ditëve te llogaritur që nga data e skadimit të atij afati kohorë.
4. Nëse personi që aplikon nuk paraqet ndonjë vërejtje apo nëse, përkundër vërejtjeve të tij, API konsideron se personi që aplikon nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara për lejimin e të drejtës së përdorimit të emrit të mbrojtur të origjinës apo treguesit gjeografik, aplikacioni refuzohet.

Neni 48**Kontrollimi në rast të produkteve bujqësore apo artikujve ushqimor**

Në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë kontrollimi dhe vendimi i përcaktuar në nenin 45 të këtij ligji merret nga komisioni i ekspertëve në bazë të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 49**Regjistrimi i përdoruesit të autorizuar**

1. Nëse aplikacioni për regjistrim të një përdoruesi të autorizuar i plotëson të gjitha kërkesat e parashkuara për dhënien e të drejtës së përdorimit të një emri të mbrojtur të origjinës apo një treguesi gjeografik API fton personin që aplikon të paguaj tarifën për periudhën fillestare të mbrojtjes.
2. Nëse personi që aplikon nuk dorëzon në API dëshmi të pagesës së kryer të tarifave të përcaktuara për periudhën fillestare të mbrojtjes në bazë të paragrafit 1. të këtij neni, API refuzon aplikacionin.
3. Nëse personi që aplikon dorëzon në API dëshmi mbi pagesën e kryer të tarifës për periudhën fillestare të mbrojtjes brenda afatit të caktuar në paragrafin 1. të këtij neni, API merr vendim për regjistrimin e një përdoruesi të autorizuar të një emri të mbrojtur të origjinës apo një treguesi gjeografik dhe regjistron emrin e mbrojtur të origjinës apo treguesin gjeografik në Regjistrin e Përdoruesve të Autorizuar.

Neni 50**Përmbajtja e shënimeve në Regjistrin e Përdoruesve të Regjistruar**

1. Në Regjistrin e Përdoruesve të Autorizuar API regjistron përdoruesin e autorizuar të një emri të mbrojtur të origjinës apo treguesi gjeografik regjistron të dhënat si në vijim:

1.1. emri dhe adresa e përdoruesit të autorizuar;

1.2. të dhënat nëse përdoruesi i autorizuar ka të drejtë të përdor emrin e origjinës apo treguesin gjeografik;

1.3. emri i regjistruar i origjinës apo treguesi gjeografik të cilin përdoruesi i autorizuar ka të drejtë të përdor;

1.4. referenca e vendimit për regjistrimin e një përdoruesi të autorizuar të emrit të origjinës apo një treguesi gjeografik.

Neni 51

Obligimi dhe mënyra e përdorimit të emrit të mbrojtur të origjinës apo treguesin gjeografik nga përdoruesi i autorizuar

1. Përdoruesi i autorizuar ka të drejtë të përdor emrin e mbrojtur të origjinës apo treguesin gjeografik vetëm në marketingun e produktit në përputhje me specifikacionin relevant.

2. E drejta e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni gjithashtu përmban të drejtën e paketimit, katalogëve, broshurave, reklamave, dokumenteve të biznesit për indentifikim dhe format tjera të dokumentacionit të biznesit, gjithashtu importit apo eksportit të produkteve të tilla.

Neni 52

Certifikata e të drejtës së përdorimit

1. API lëshon certifikatën për të drejtën e përdorimit të një emërtimit të origjinës apo treguesi gjeografik në bazë të kërkesës së përdoruesit të autorizuar dhe dëshmisë për pagesën e tarifës.

2. Ministria me akt nënligjor përcakton të dhënat që përmban certifikata e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 53

Regjistrimi i ndryshimeve në Regjistrin e Përdoruesve të Autorizuar

Me anë të kërkesës nga përdoruesi i autorizuar, API regjistron të gjitha ndryshimet lidhur me emrin dhe adresën e përdoruesit të autorizuar, me kusht që kërkesa është e shoqëruar me dëshmi adekuate se ndryshimi nuk ndikon në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara për dhënien e të drejtës së përdorimit të një emri të mbrojtur të origjinës apo treguesi gjeografik.

Neni 54

Përtërirja e regjistrimit të një përdoruesi të autorizuar

1. Regjistrimi i një përdoruesi të autorizuar do të përtërihet për periudhën e caktuar në paragrafin 2. të nenit 15 të këtij ligji me kusht që emri i origjinës apo treguesi gjeografik që i referohet të mbes i regjistruar dhe pas kërkesës së parashtruar nga përdoruesi i autorizuar e cila duhet të shoqërohet me dokumentet vijuese:

1.1. certifikata e përputhshmërisë së produktit me dispozitat e specifikacionit të lëshuar

nga autoritetet apo organet e besuara për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve me dispozitat e specifikacionit;

1.2. dëshmi për pagesën e kryer të tarifave përkatëse

Neni 55

Revokimi i regjistrimit të një përdoruesi të autorizuar

Nëse API vërteton se përdoruesi ka pushuar të përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara për dhënien e të drejtës së përdorimit të një emri të mbrojtur të origjinës apo treguesi gjeografik, API do të marr vendim për revokimin e regjistrimit të një përdoruesi të autorizuar pas përfundimit së procedurës për revokim në API.

Neni 56

Procedura e revokimit

1. Procedura e revokimit e përcaktuar në nenin 55 të këtij ligji inicohet sipas detyrës zyrtare apo me anë të kërkesës për revokim e cila mund të parashtrohet nga çdo person fizik dhe juridik që ka interes legjitim.

2. API njofton përdoruesin e autorizuar mbi faktin se procedura e revokimit është iniciuar dhe do ta ftoj atë të dorëzoj vërejtjet e tij, në veçanti të dëshmoj ekzistencën e kërkesave të përcaktuara për dhënien e të drejtës së përdorimit të një emri të mbrojtur të origjinës apo treguesi gjeografik brenda tridhjetë (30) ditëve.

3. Me anë të kërkesës së përdoruesit të autorizuar e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, ai afat i kufizuar kohor mund të zgjatet edhe për tridhjetë (30) ditëve duke i llogaritur që nga data e skadimit të afatit kohor.

4. Nëse API konstaton se kërkesa për revokim të regjistrimit të një përdoruesi të autorizuar është e bazuar, anulon regjistrimin e përdoruesit të regjistruar dhe fshin emrin e tij nga Regjistri i Përdoruesve të Autorizuar pasi që vendimi mbi revokimin të merr formën e prerë.

5. API refuzon kërkesën për anulimin e regjistrimit të një përdoruesi të autorizuar nëse konstaton se ajo është e pa bazuar.

Neni 57

Revokimi i procedurës në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimor

Në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë vendimet e përcaktuara në nenin 55 dhe 56 të këtij ligji merren nga komisioni i ekspertëve i bazuar në nenin 32 të këtij ligji.

Neni 58

Pushimi i të drejtës së përdorimit

1. E drejta e përdorimit do të pushoj së ekzistuari nëse:

1.1. periudha e mbrojtjes skadon dhe nuk është përtërirë sipas nenit 44 të këtij ligji, që nga data e skadimit të periudhës së mbrojtjes;

1.2. përdoruesi i autorizuar heq dorë nga e drejta e përdorimit, që nga data e dorëzimit të njoftimit në API;

1.3. përdoruesi i autorizuar pushon së ekzistuari që nga data e atij fakti apo vendimi i autoritetit kompetent që e vërteton këtë fakt;

1.4. regjistrimi i përdoruesit të autorizuar anulohet, konsiderohet se regjistrimi i përdoruesit të autorizuar nuk ka ekzistuar që nga fillimi;

1.5. regjistrimi i përdoruesit të autorizuar është i revokuar, që nga data kur vendimi mbi revokim merr formën e prerë;

1.6. emri i origjinës apo treguesi gjeografik nuk është i mbrojtur më tutje sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 59

Anulimi i të drejtës së përdorimit

Vendimi për regjistrimin e përdoruesit të autorizuar anulohet nëse API vërteton se gjatë zhvillimit të procedurës, në kohën e plotësimit të aplikacionit për regjistrim të një përdoruesi të autorizuar, kushtet për mbrojtje nuk ishin plotësuar sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 60

Procedura e anulimit të drejtës së përdorimit

1. Procedura e anulimit e përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji iniciohet sipas detyrës zyrtare apo me anë të kërkesës kundër vendimit për regjistrimin e përdoruesit të autorizuar e cila parashtrohet nga çdo person juridik dhe fizik që ka interes legjitim.

2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni përmban arsyet për kërkesën dhe çdo informatë tjetër apo dokument të kërkuar me akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

3. Nëse API konstaton se kërkesa nuk i përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas paragrafit 2. të këtij neni kërkesa refuzohet.

4. Nëse API konstaton se kërkesa për anulim është paraqitur në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, kërkesa për anulim së bashku me të gjitha dëshmitë e dorëzuara do të dërgohet përdoruesit të autorizuar dhe përdoruesi i autorizuar fton palën të dorëzojë vërejtjen e tij për kërkesën e parashtruar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve.

5. Me anë të kërkesës nga përdoruesi i autorizuar e cila duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohorë të referuar në paragrafin 4. të këtij neni, afati kohorë mund të zgjatet edhe për tridhjetë (30) ditë duke llogaritur që nga data e skadimit të atij afati të kufizuar kohorë.

6. Nëse API konstaton se kërkesa për anulim të vendimit për regjistrimin e përdoruesit të autorizuar është e bazuar, API anulon atë dhe e fshin regjistrimin nga Regjistri i Përdoruesve të Autorizuar pasi që vendimi mbi anulimin të merr formën e prerë.

7. API refuzon kërkesën për anulimin e vendimit mbi regjistrimin e një përdoruesi të autorizuar

nëse konstaton se nuk është e bazuar.

Neni 61

Procedura e anulimit në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë

Në rastet e produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë vendimi i përcaktuar në nenin 59 dhe 60 të këtij ligji merret nga komisioni i ekspertëve i bazuar në nenin 32 të këtij ligji.

Neni 62

Përdorimi i emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik që lidhen me zonat gjeografike jashtë Kosovës

Dispozitat e Kapitullit V që rregullojnë procedurën për regjistrimin e përdoruesve të autorizuar të emërtimeve të mbrojtura të origjinës ose të treguesve të mbrojtur gjeografik, nuk zbatohen në lidhje me emërtimet e origjinës dhe të treguesve gjeografik që lidhen me zonat gjeografike jashtë Kosovës.

KAPITULLI VI

MBROJTJA CIVILE – JURIDIKE

Neni 63

Shkelja e të drejtës

Çdo përdorim i paautorizuar i emrit të origjinës apo treguesit gjeografik apo çfarëdo simboli apo praktike të ndaluar sipas nenit 12 dhe 14 të këtij ligji paraqet shkelje të emrit të origjinës apo treguesit gjeografik.

Neni 64

Personat që kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave

Mbrojtja e të drejtave nga ky Ligj mund të kërkohet nga një grup ose nga një person i vetëm që ka parashtruar kërkesën për regjistrim, çdo përdorues i autorizuar apo grup i përdoruesve të autorizuar ose personi i autorizuar nga ndonjëri prej tyre në pajtim me dispozitat e përgjithshme për përfaqësimin, apo Prokurori i Shtetit.

Neni 65

Procedura për konstatimin dhe ndalimin e shkeljes

1. Në bazë të nenit 62 të këtij Ligji, pretenduesi mund të parashtojë Padi në gjykatë për konstatimin e shkeljes së të drejtës së një emri të origjinës apo të një treguesi gjeografik, kundër personit i cili ka shkelur të drejtën e një emri të origjinës apo treguesi gjeografik duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 12 dhe 14 të këtij Ligji, duke kërkuar:

1.1. konstatimin e shkeljes së emrit të origjinës apo treguesit gjeografik;

1.2. ndalimin e shkeljes dhe ndalimin e vazhimit të shkeljeve të tilla dhe të ngjashme në të ardhmen.

2. Në bazë të Nenit 63 të këtij Ligji, pretenduesi mund të parashtrojë një kërkesë ndaj çdo personi që duke kryer ndonjë prej akteve pa autorizim ka shkaktuar kërcënim serioz që emërtimet e origjinës apo treguesi gjeografik mund të shkelen, duke pretenduar largimin nga akti në fjalë dhe ndalimin e shkeljes së emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik.

3. Veprimet e referuara në nën-paragrafët 1.1. dhe , 1.2. të paragrafit 1 dhe paragrafit 2, të këtij neni mund të bëhen gjithashtu edhe kundër personave të cilët gjatë aktivitetit të tyre ekonomike kanë kryer shërbime duke shkelur emrin e origjinës apo treguesin gjeografik apo paraqesin kërcënim për shkelje të drejtave të një emri të origjinës apo treguesi gjeografik.

Neni 66

Kërkesë për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve

1. Pretenduesi në pajtim me nenin 63 të këtij Ligji mund të ndërmarr veprim ligjor kundër çdo personi i cili ka kryer shkelje të një emri të origjinës apo treguesi gjeografik duke kryer pa autorizim njërin prej akteve të referuar në nenin 12 apo nenin 14 të këtij Ligji, duke kërkuar që produktet që shkelin emrin e origjinës apo treguesin gjeografik dhe në raste të duhura, materialet dhe mjetet e përdorura kryesisht në krijimin apo prodhimin e atyre produkteve të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen në llogari të atij personi.

2. Gjykata urdhëron masat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni në llogari të të paditurit, përveç nëse ekzistojnë arsye të veçanta për të mos marrë një vendim të tillë.

3. Në rast të urdhërimit të masës së referuar në paragrafin 1. të këtij neni, Gjykata do të kujdeset që ato të jenë të duhura në lidhje me natyrën dhe seriozitetin e shkeljes dhe duhet marr parasysh edhe interesin e palëve të treta.

Neni 67

Kërkesa për kompensim të demit

1. Në bazë të nenit 63 të këtij ligji pretenduesi mund të inicioj padi kundër personit i cili i ka shkaktuar dëm duke kryer veprime të pa autorizuar në bazë nenit 12 dhe 14 të këtij ligji, dhe të kërkoj kompensimin e demit.

2. Në bazë të nenit 63 të këtij Ligji pretenduesi mund të inicioj padi kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprimet e cekura në nenin 10 të këtij ligji, i cili ka përfituar pa bazë ligjore duke shkelur emrin e origjinës apo treguesin gjeografik, dhe të kërkoj kthimin apo kompensimin e atyre përfitimeve, sipas dispozitave të përgjithshme për përfitimin e pa bazë.

3. Kërkesat sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni nuk e përjashtojnë njëra tjetrën.

4. Me rastin e shqiptimit të gjobave gjykata duhet t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat e duhura, si pasojat negative ekonomike, përfshirë fitimin e humbur, të cilat i ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë të bërë nga shkelësi dhe në rastet e duhura, elementet e tjera, përveç faktorëve ekonomik, të tilla si paragjykimi moral që u është shkaktuar pronarëve të të drejtave nga kjo shkelje.

Neni 68

Kërkesa për publikimin e aktgjykimit

1. Në bazë të nenit 63 të këtij ligji, me kërkesën e pretenduesit aktgjykimi i formës së prerë publikohet në mjetet e informimit publik me shpenzimet e të paditurit.
2. Gjykata vendos brenda kufijve të kërkesës për publikimin e tërësishëm ose pjesërisht të aktgjykimit dhe mjetin e informimit se ku do të bëhet publikimi.

Neni 69

Kërkesa për informacione

1. Në bazë të nenit 63 të këtij ligji, pretenduesi i cili ka filluar procedurën për mbrojtjen e një emri të origjinës apo treguesi gjeografik në rastet e shkeljes, mund të kërkojë informacionet për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve të cilat e shkelin emrin e origjinës apo treguesin gjeografik.

2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqitet në formë të padisë ose për marrjen e masave të përkohshme kundër:

- 2.1. personit kundër të cilit është ngritur padi sipas paragrafit 1. të këtij neni;
- 2.2. personit i cili në kuadër të aktivitetit të tij afarist posedon produkte për të cilat ekziston dyshimi se kanë shkelur një emri të origjinës apo treguesi gjeografik;
- 2.3. personit i cili gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij afarist ofron shërbime, për të cilat dyshohet se shkelin një emër të origjinës apo tregues gjeografik;
- 2.4. personave të cilët gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre afarist ofrojnë shërbime apo përdorin shërbimet e ofruara në aktivitetet e dyshuara që shkelin një emër të origjinës apo treguesi gjeografik;
- 2.5. personit për të cilin dëshmohet se është përfshirë në prodhimin ose shpërndarjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve të dyshuara se shkelin një emri të origjinës apo treguesi gjeografik.

3. Kërkesa për informacione për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të përfshijë në veçanti:

- 3.1. informatat për emrat dhe adresat e prodhueseve, shpërndarësve, furnitorëve dhe pronarëve të tjerë të mëparshëm të produkteve dhe shërbimeve, shitësve me shumicë dhe pakicë;
- 3.2. informatat për sasinë e prodhuara, shpërndara, pranuar dhe porositura, si dhe çmimin për produktet dhe shërbimet.

4. Personi të cilit i kërkohet ta ofrojë informacionin e referuar në këtë nen mund të refuzojë ta ofrojë informacionin e tillë mbi të njëjtat baza si ato të cilat në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi e lejojnë refuzimin për të paraqitur dëshmi si dëshmitar. Nëse personi në fjalë refuzon të ofrojë

informacion pa arsye të bazuar, ajo / ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Dispozitat e këtij neni duhet të jenë pa paragjykim ndaj dispozitave për mënyrën e përdorimit të informacionit konfidencial në procedurat civile dhe penale, dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë për keqpërdorimin e të drejtës për të marrë informacion, si dhe dispozitat që rregullojnë përpunimin dhe mbrojtjen e personale të dhënave.

6. Dispozitat e këtij neni duhet të jenë pa paragjykim ndaj dispozitave të Neneve 70 dhe 71 të këtij Ligji që rregullon marrjen e provave.

Neni 70

Masat e përkohshme në rastet e shkeljes së një emri të origjinës apo treguesi gjeografik

1. Me kërkesë të pretenduesit, në bazë të nenit 63 të këtij Ligji i cili dëshmon se emri i origjinës apo treguesi gjeografik është shkelur apo tentohet të shkelet, gjykata urdhëron çfarëdo mase të përkohshme që përfshin ndalimin apo parandalimin e shkeljes, në veçanti:

1.1. të urdhëroj shkelësin e supozuar që t'i ndalojë dhe t'i ndërpresë veprimet që shkelin një emri të origjinës apo treguesi gjeografik; gjykata po ashtu mund të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin një emri të origjinës apo treguesi gjeografik;

1.2. të urdhëroj konfiskimin apo largimin nga tregu të produkteve që pa të drejtë emërtohen si një emri të origjinës apo treguesi gjeografik.

2. Me kërkesë të pretenduesit, në bazë të nenit 63 të këtij Ligji i cili dëshmon se emri i origjinës apo treguesi gjeografik është shkelur në nivel komercial me qëllim të sigurimit të përfitimit ekonomik ose komercial dhe se shkelja tenton që t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm, gjykata përveç masave të përkohshme të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të palës kundërshtuese, e cila nuk është drejtpërdrejt e lidhur me shkeljen, duke përfshirë edhe ngrirjen e llogarive të tij bankare dhe aseteve të tjera.

3. Me qëllim të caktimit dhe ekzekutimit të masës së përkohshme sipas paragrafit 2. të këtij neni, gjykata kërkon nga pala kundërshtare ose personat e tjerë përkatës, paraqitjen e informacioneve bankare, financiare dhe informacioneve të tjera ekonomike, ose vënien në disponim të informacioneve dhe dokumenteve të tjerë në lidhje me to. Gjkata siguron mbrojtjen e konfidencialitetit të informacioneve të tilla dhe e ndalon shpërdorimin e tyre.

4. Masa e përkohshme e percaktuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të urdhërohet pa e informuar palën kundërshtuese të saj, nëse aplikuesi për masat dëshmon se në të kundërtën masa e përkohshme nuk do të jetë efektive, ose që është kërcënuar që të ndodhë dëmtimi i pariparueshëm. Masa e përkohshme e percaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të urdhërohet pa e informuar palën kundërshtuese të saj, nëse aplikuesi për masat dëshmon se në të kundërtën masa e përkohshme nuk do të jetë efektive, ose që, duke i marrë në konsideratë rrethanat shumë të rënda të shkeljes, kjo do të jetë e domosdoshme. Në qoftë se masa e përkohshme është urdhëruar pa e njoftuar palën kundërshtuese, gjykata duhet t'ja komunikojë vendimin për masën e përkohshme palës kundërshtuese, menjëherë pas zbatimit të saj.

5. Në vendimin për masën e përkohshme, gjykata cakton kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse është urdhëruar ndonjë masë para fillimit të procedurës, periudhën brenda së cilës aplikuesi i masës duhet ta iniciojë procedurën për të arsyetuar masën, e që duhet të jetë jo më shkurtër se njëzet (20) ditë pune dhe jo më e gjatë se tridhjetë e një (31) ditë kalendarike, nga data e shqiptimit të masës së përkohshme, cilado që të skadojë më vonë.

6. Kur masat e përkohshme të percaktuara në këtë nen revokohen ose kur ato skadojnë për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e paditësit, apo ku më pas është gjetur se nuk ka pasur shkelje të emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik apo kërcënim të shkeljes së tillë, me kërkesë të kundërshtuesit gjykata mund ta urdhërojë paditësin që t'ia ofrojë të pandehurit kompensimin përkatës për çdo dëmtrim të shkaktuar nga këto masa të përkohshme. Për të siguruar kompensim masat e përkohshme të percaktuara në këtë nen mund të jetë subjekt i depozitimit të një garancie të përshtatshme ose të një sigurimi ekuivalent për këtë qëllim nga ana e aplikuesit.

7. Për çështjet që nuk rregullohen me këtë nen duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Neni 71

Masat e përkohshme që përmbajnë ruajtjen e dëshmise

1. Me kërkesë të pretenduesit, në bazë të nenit 63 të këtij Ligji i cili dësmon se emri i origjinës apo treguesi gjeografik është shkelur apo tentohet të shkellet, gjykata mund të urdhërojë marrjen e masave të përkohshme që përfshinë mbrojtjen e dëshmisë:

2. Për masat e përkohshme të percaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të urdhërojë në veçanti:

2.1. përgatitjen e përshkrimit të hollësishëm të mallrave që kanë mundësi të shkelin emrin e origjinës apo treguesin gjeografik, me apo pa marrjen e mostrave;

2.2. konfiskimi i produkteve që kanë mundësi të shkelin emrin e origjinës apo treguesin gjeografik;

2.3. konfiskimi i materialeve dhe mjeteve të përdorura në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve që kanë mundësi të shkelin emrin e origjinës apo treguesin gjeografik dhe dokumentet e lidhura me ato.

3. Masa e përkohshme e percaktuar në këtë nen mund të urdhërohet edhe pa e informuar palën kundërshtuese të saj, nëse personi që aplikon supozon se ekziston rreziku që dëshmitë të shkatërrohen apo të shkaktohet dëm i pariparueshëm. Në qoftë se masa e përkohshme është e urdhëruar pa e informuar palën kundërshtuese të saj, gjykata do t'ia komunikojë palës kundërshtuese vendimin mbi masën e përkohshme menjëherë me zbatimin e saj.

4. Në vendimin për masën e përkohshme, gjykata cakton kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse është urdhëruar ndonjë masë para fillimit të procedurës, periudhën brenda së cilës aplikuesi i masës duhet ta iniciojë procedurën për të arsyetuar masën, e që nuk duhet t'i kalojë njëzet (20) ditë pune dhe jo më e gjatë se tridhjetë e një (31) ditë kalendarike, nga data e shqiptimit të masës së përkohshme, cilado që të skadojë më vonë.

5. Dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore do të zbatohen për çështjet që nuk janë të

rregulluar me anë të këtij neni.

6. Dispozitat e këtij neni do të jenë pa paragjykime ndaj mundësisë së gjykatës të urdhëroj masa të përkohshme që përmbajnë ruajtjen e dëshmive në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

7. Kur masat e përkohshme të percaktuara në këtë nen revokohen ose kur ato skadojnë për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e paditësit, apo ku më pas është gjetur se nuk ka pasur shkelje të emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik apo kërcënim të shkeljes së tillë, me kërkesë të kundërshtuesit gjykata mund ta urdhërojë paditësin që t'ja ofrojë të pandehurit kompensimin përkatës për çdo dëmtim të shkaktuar nga këto masa të përkohshme. Për të siguruar kompensim për masat e përkohshme të percaktuara në këtë nen mund të jetë subjekt i depozitimit të një garancie të përshtatshme ose të një sigurimi ekuivalent për këtë qëllim nga ana e aplikuesit.

Neni 72

Marrja e provave gjate zhvillimit të procedurës civile

1. Kur pala në procedurë civile kërkon dëshmi duke pohuar se ato qe ndodhen me palën kundërshtuese apo nën kontroll të saj, gjykata do ta ftoj palën kundërshtuese që brenda afatit të caktuar kohor ti paraqes dëshmitë e tilla.

2. Kur pretenduesi në bazë të Nenit 63 të këtij Ligji përmes veprimit ligjor pohon se shkelja e emëruesit të origjinës dhe treguesit gjeografik është kryer në nivel komercial për qëllime të sigurimit të përfitimit komercial apo ekonomik, dhe kur ai gjatë procedurës dëshmon duke kërkuar dokumente bankare, financiare apo dokumente të ngjashme ekonomike, letra apo dëshmi të ngjashme, duke pohuar se ato ndodhen me palën kundërshtuese apo janë nën kontroll të saj, Gjykata do të ftoj palën kundërshtuese që brenda afatit të caktuar kohor t'i paraqes dëshmitë e tilla.

3. Kur pala e cila është ftuar të paraqes dëshminë, mohon se dëshmitë ndodhen me të apo janë nën kontroll të saj, gjykata mund të marr dëshmi për të vërtetuar një fakt të tillë.

4. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore lidhur me të drejtën e refuzimit të paraqes dëshmi si dëshmitarë do të zbatohen mutatis mutandis për të drejtën e palës të refuzoj të paraqes dëshmi.

5. Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, vendos sipas zgjidhjes së saj, mbi rëndësinë e faktit që pala në posedim të dëshmisë refuzon të pajtohet me vendimin e gjykatës që e urdhëron të paraqes dëshmitë, apo mohon, në kundërshtim të vendimit të gjykatës, se dëshmitë ndodhen me të.

6. Kundër vendimit të gjykatës të percaktuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, nuk lejohet ankesë e veçantë.

Neni 73

Procedurat përshpejtuese dhe zbatimi i dispozitave të ligjeve të tjera

1. Procedura në lidhje me shkeljen e një emri të origjinës apo treguesi gjeografik duhet të jetë e përshpejtuar.

2. Gjatë procedurës në lidhje me shkeljen e të drejtës së një emri të origjinës apo treguesi gjeografik zbatohen edhe dispozitat e Ligjeve mbi Procedurën Kontestimore dhe mbi Procedurën Përmbartimore.

3. Me kërkesë të gjykatës ose të palës që ka iniciuar procedurën për shkeljen e së drejtës së një emri të origjinës apo treguesi gjeografik, API pranon kërkesën për anulimin apo shpalljen e pavlefshëm të vendimit për një emri të origjinës apo treguesi gjeografik e regjistruar, të paraqitur para ose gjatë procedurës dhe do të veprojë në procedurë të shpejtë.

4. Gjykata duke marrë parasysh rrethanat mund të vendosë ndërprerjen e procedurës deri të vendimi përfundimtar.

Neni 74

Kompetencat e gjykatës

Për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të një emri të origjinës apo treguesi gjeografik vendosë Gjykata kompetente sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

KAPITULLI VII

DISPOZITA NDËSHKUESE

Neni 75

Dispozitat ndëshkuese

1. Çdo subjekt i cili pa autorizim përdor emrin e origjinës apo treguesin gjeografik në kundërshtim me nenin 9 ose nenin 12 të këtij ligji, ose tregon ndonjë produkt në kundërshtim me paragrafin 1. të nenit 51 të këtij ligji dënohet për kundërvajtje në vlerë prej tremijë (3.000) € deri nëntëmijë (9.000) €.

2. Personi fizik dënohet për kundërvajtje, të referuar në paragrafin 1. të këtij neni, me një gjobë në vlerë prej dyqind e pesëdhjetë (250) € deri shtatëqind e pesëdhjetë (750) €.

3. Personi i përgjegjshëm në personin juridik dënohet për kundërvajtje, të referuar në paragrafin 1. të këtij neni, me një gjobë në vlerë prej pesëqind (500)€ deri njëmijë e pesëqind (1.500) €.

4. Produktet e caktuara apo të përdorura për kundërvajtjen e referuar në këtë nen konfiskohen dhe me vendimin e formës së prerë të gjykatës kompetente shkatërrohen, duke u bërë të paidentifikueshme ose të papërdorshme në ndonjë mënyrë.

Neni 76

Mbikëqyrja dhe kontrolli sipas detyrës zyrtare

1. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij Ligji duhet të zbatohet nga inspektorati përkatës në territorin e Kosovës.

2. Inspektorati përkatës në territorin e Kosovës duhet të veprojë si autoritet kompetent përgjegjës për kontrollet zyrtare të kryera për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore në lidhje me emërtimin e origjinës ose treguesit gjeografik të përcaktuar me këtë Ligj.

3. Autoriteti kompetent i referuar në paragrafin 2 duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme të objektivitetit dhe paanshmërisë dhe duhet që të ketë në dispozicion një personel të kualifikuar dhe burimet e nevojshme për të kryer funksionin e tyre.

4. Kontrolli zyrtar që duhet të kryhet nga inspektorati përkatës duhet të mbulojnë verifikimin se a përputhet produkti me specifikimet përkatëse të produktit dhe monitorimin e përdorimit të emrave të regjistruar për të përshkruar vendin e produkteve në treg në pajtim me nenin 12 të këtij Ligji.

KAPITULLI VIII SPECIALITETET TRADICIONALE TË GARANTUARA

Neni 77

Dispozitat e veçanta për specialitete tradicionale të garantuara

Dispozitat e këtij ligji zbatohen *mutatis mutandi* për specialitete tradicionale të garantuara përveç nëse Nenet 77-83 parashikojnë ndryshe.

Neni 78

Kriteret për të drejtën e regjistrimit

1. Një emër ka të drejtë për regjistrim si një specialitet tradicional i garantuar ku ai përshkruan një produkt specifik apo një ushqim që:

1.1. rezulton nga mënyra e prodhimit, përpunimit ose përbërjes që korrespondon me praktikën tradicionale për atë produkt ose ushqim; ose

1.2. është prodhuar nga materialet e papërpunuara ose përbërës që janë ato që përdoren tradicionalisht.

2. Që një emër të jetë i regjistruar si një specialitet tradicional i garantuar, duhet që:

2.1. të përdoret tradicionalisht duke ju referuar produktit specifik, ose

2.2. ta identifikojë karakterin tradicionale ose karakterin specifik të produktit.

3. Në qoftë se në procedurën e kundërshtimit është demonstruar se emri është përdoret edhe në një vend të tretë, për të dalluar produktet e ngjashme ose produktet që ndajnë një emër identik ose të ngjashëm, vendimi i marrë për regjistrim mund të parashikojë që emri i specialitetit tradicional të garantuar duhet të shoqërohet me pohimin "i bërë duke ndjekur traditën e" përcjellë menjëherë nga emri i vendit ose rajonit të saj.

4. Emri nuk mund të regjistrohet nëse i referohet vetëm pretendimeve të një natyre të përgjithshme të përdorur për një grup të produkteve, ose të kërkesave të parashikuara nga legjislacioni të caktuar që është në fuqi në Kosovë.

Neni 79

Specifikimi i produktit

1. Specialiteti tradicional i garantuar duhet të jetë në pajtim me specifikimin i cili duhet të përmbajë:

- 1.1. emrin e propozuar për regjistrimin;
- 1.2. përshkrimin të produktit, duke përfshirë karakteristikat e saj kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike apo organoleptike, duke e paraqitur karakterin e veçantë të produktit;
- 1.3. përshkrimin të metodës së prodhimit që duhet ta ndjekin prodhuesit, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, natyrën dhe karakteristikat e lëndëve të para ose të përbërësve të përdorur, dhe metodën me të cilën është përgatitur produkti dhe
- 1.4. elementet kyçe të cilat e krijojnë karakterin tradicional të produktit, dhe
- 1.5. çdo kërkesë tjetër e cila është e përshkruar në aktin nënligjor për zbatimin e këtij ligji.

Neni 80

Përmbajtja e aplikacionit për regjistrim

1. Aplikacioni për regjistrimin e një emri si një specialitet tradicional i garantuar përfshinë:

- 1.1. emrin dhe adresën e grupit të aplikimit;
- 1.2. specifikimet e produktit, siç parashikohet në nenin 78.

Neni 81

Bazat për kundërshtim

1. Deklarata e arsyetuar e kundërshtimit, siç referohet në nenin 33, do të jetë e pranueshme vetëm nëse ajo është pranuar nga Agjencia përpara skadimit të afatit kohor dhe nëse ajo:

- 1.1. jep arsye të arsyetuara pse regjistrimi i propozuar nuk është në përputhje me kushtet e këtij ligji, ose
- 1.2. tregon se përdorimi i emrit është e ligjshëm, i njohur dhe ekonomikisht i rëndësishëm për produkte të ngjashme bujqësore ose ushqimore.

Neni 82

Regjistri i specialiteteve tradicionale të garantuara

1. Agjencia do të mbajë një regjistër të përditësuar të specialitete tradicionale të garantuara të njohur me këtë ligj i cili do të jetë për qasje publike.

2. Përmbajtja e regjistrit të referuar në paragrafin 1 i këtij neni duhet të përcaktohen me akt

nënligjor të nxjerrë nga Ministria përkatëse.

Neni 83

Emrat, simboli dhe treguesi

1. Emri i regjistruar si specialitet tradicional i garantuar mund të përdoret nga çdo operator marketingut të një produkti që përputhet me specifikimet përkatëse. Dispozitat e Kapitullit të V nuk duhet të zbatohen në lidhje me specialitetin tradicional të garantuar.
2. Çdo produkt me origjinë në Kosovë i tregtuar si një specialitet tradicional i garantuar il regjistruar në përputhje me këtë Ligj duhet të etiketohet me treguesin “specialitet tradicional i garantuar” apo me simbol të lidhur me të.
3. Çdo produkt me origjinë jashtë Kosovës i tregtuar si një specialitet tradicional i garantuar i regjistruar në përputhje me këtë Ligj duhet të etiketohet me treguesin “specialitet tradicional i garantuar” apo me simbol të lidhur me të.
4. Simboli i projektuar për të publikuar specialitetin tradicional të garantuar dhe për ta shoqëruar treguesin specialitet tradicional i garantuar”, kur përdoret në përputhje me këtë Nen duhet të përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 84

Kufizimi në përdorimin e emrave të regjistruar

Emrat e regjistruar duhet të mbrohen nga çdo keqpërdorim, imitim ose evokim, ose kundër çfarëdo praktike tjetër përgjegjëse për ta çorientuar konsumatorin.

KAPITULLI IX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 85

Zbatimi i dispozitës së Ligjit mbi Markën Tregtare

1. Personat e huaj fizik dhe juridik pa qëndrim të përhershëm, vendbanim apo seli kryesore për biznes në Republikën e Kosovës duhet të përfaqësohen pranë API- se në të gjitha procedurat e caktuara nga ky ligj nga një agjent për markën tregtare në përputhje me dispozitat e Kapitullit XIV të Ligjit mbi Markën Tregtare.
2. Personat fizik dhe juridik të cilët kanë seli kryesore të biznesit, qëndrim të përhershëm apo vendbanimi në Republikën e Kosovës mund të përfaqësohen në API në procedurat e caktuara nga ky ligj nga një agjent për markë tregtare në përputhje me dispozitat e Kapitullit XIV të Ligjit mbi Markën Tregtare.
3. Personat juridik të cilët kanë seli kryesore të biznesit, qëndrim të përhershëm apo vendbanim në Republikën e Kosovës mund të përfaqësohet në API në procedurat e caktuara nga ky ligj nga ndonjë punonjës me autorizim të nënshkruar nga personi juridik.
4. Dispozitat e Kapitullit XIV të Ligjit mbi Markën Tregtare që kanë të bëjnë me përfaqësimin

do të zbatohen në pajtim me përfaqësimin në fushën e emrave të origjinës ose treguesve gjeografik.

Neni 86

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria për zbatimin e këtij ligji do të nxjerr akte nënligjore në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 87

Aktet nënligjore të aplikueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore

1. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, aktet nënligjore të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi si në vijim:

1.1. Udhëzim administrativ nr. 04/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ nr. 12/2012 për tarifatat administrative të regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale;

1.2. Udhëzim administrativ nr. 05/2014 për procedurat e regjistrimit të treguesit gjeografik dhe emërtimit të origjinës;

Neni 88

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr.04/L-187 për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës.

Neni 89

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-051

14 dhjetor 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-039-2015, datë 29.12.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga

